189.	S SH EN 13274-7:2008 Pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes – Metodat e provës – Pjesa 7: Përcaktimi i depërtimit të grimcave në filtër	2008	Fp
190.	S SH EN 13274-8:2002 Pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes – Metodat e provës – Pjesa 8: Përcaktimi i bllokimit nga pluhuri i dolomitit	2002	Fp
191.	S SH EN 13277-1:2000 Pajisje mbrojtëse për artet marciale – Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme dhe metodat e provave	2000	Fp
192.	S SH EN 13277-2:2000 Pajisje mbrojtëse për artet marciale – Pjesa 2: Kërkesa dhe metoda prove shtesë për mbrojtëset e kurrizit të këmbës, mbrojtëset e tibias së këmbës dhe mbrojtëset e parakrahut	2000	Fp
193.	S SH EN 13277-3:2000 Pajisje mbrojtëse për artet marciale – Pjesa 3: Kërkesat shtesë dhe metodat e provës për mbrojtëset e trupit	2000	Fp
	S SH EN 13277-3:2000/A1:2007	2007	Fp
194.	S SH EN 13277-4:2001 Pajisje mbrojtëse për artet marciale – Pjesa 4: Kërkesat shtesë dhe metodat e provës për mbrojtëset e kokës	2001	Fp
	S SH EN 13277-4:2001/A1:2007	2007	Fp
195.	S SH EN 13277-5:2002 Pajisje mbrojtëse për artet marciale (luftarake) – Pjesa 5: Kërkesat shtesë dhe metodat e provës për mbrojtëset e organeve gjenitale dhe për mbrojtëset e barkut	2002	Fp
196.	S SH EN 13277-6:2003 Pajisje mbrojtëse për artet marciale (luftarake) – Pjesa 6: Kërkesat shtesë dhe metodat e provës për mbrojtëset e gjoksit të femrave	2003	Fp
197.	S SH EN ISO 13287:2007 Këpucë sigurie dhe mbrojtëse për përdorim profesional – Metoda e provës për rezistencën në rrëshqitje	2007	Fp
198.	S SH EN 13356:2001 Pajisje ndihmëse shikimi për përdorim joprofesional – Metodat e provës dhe kërkesat	2001	Fp
199.	S SH EN 13484:2001 Pajisje mbrojtëse për rrëshqitëset	2001	Fp
200.	S SH EN 13546:2002 Veshje mbrojtëse – Mbrojtëset e dorës, krahut, gjoksit, barkut, këmbës, shputës dhe organeve gjenitale të portierëve të hokejit dhe mbrojtëset e kërcirit për lojtarët – Kërkesat dhe metodat e provës	2002	Fp

	S SH EN 13546:2002/A1:2007	2007	Fp
201.	S SH EN 13567:2002 Veshje mbrojtëse – Mbrojtëset e dorës, krahut, gjoksit, barkut, këmbës, organeve gjenitale dhe fytyrës të skermistëve – Kërkesat dhe metodat e provës	2002	Fp
	S SH EN 13567:2002/A1:2007	2007	Fp
202.	S SH EN 13594:2002 Dorashka mbrojtëse për motoçiklistët profesionistë – Kërkesat dhe metodat e provës	2002	Fp
203.	S SH EN 13595-1:2002 Veshje mbrojtëse për motoçiklistët profesionistë – Xhaketat, pantallonat dhe kominoshet njëpjesëshe ose të ndara – Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme	2002	Fp
204.	S SH EN 13595-2:2002 Veshje mbrojtëse për motoçiklistët profesionistë – Xhaketat, pantallonat dhe kominoshet njëpjesëshe ose të ndara - Pjesa 2: Metoda e provës për përcaktimin e rezistencës abrazive në goditje	2002	Fp
205.	S SH EN 13595-3:2002 Veshje mbrojtëse për motoçiklistët profesionistë – Xhaketat, pantallonat dhe kominoshet njëpjesëshe ose të ndara – Pjesa 3: Metoda e provës për përcaktimin e qëndrueshmërisë në plasje	2002	Fp
206.	S SH EN 13595-4:2002 Veshje mbrojtëse për motoçiklistët profesionistë – Xhaketat, pantallonat dhe kominoshet njëpjesëshe ose të ndara – Pjesa 4: Metoda e provës për përcaktimin e rezistencës në prerje nga goditja	2002	Fp
207.	S SH EN 13634:2002 Këpucë mbrojtëse për motoçiklistët profesionistë– Kërkesat dhe metodat e provës	2002	Fp
208.	S SH EN 13781:2001 Helmata mbrojtëse për drejtuesit dhe pasagjerët e mjeteve motorike që lëvizin në dëborë dhe të slitave të garave	2001	Fp
209.	S SH EN 13794:2002 Pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes – Aparate respirimi shpëtimi me vetëpërmbajtje dhe me qark të hapur	2002	Fp
210.	S SH EN 13819-1:2002 Mbrojtësit e dëgjimit – Provat – Pjesa 1: Metodatat fizike të provës	2002	Fp
211.	S SH EN 13819-2:2002 Mbrojtësit e dëgjimit – Provat – Pjesa 2: Metodatat akustike të provës	2002	Fp
212.	S SH EN 13832-1:2006 Këpucë mbrojtëse kundër produkteve kimike – Pjesa 1: Terminologjia dhe metodat e provës	2006	Fp
213.	S SH EN 13832-2:2006 Këpucë mbrojtëse kundër produkteve kimike – Pjesa 2: Kërkesat për këpucët rezistentë ndaj produkteve kimike në kushtet laboratorike	2006	Fp

214.	S SH EN 13832-3:2006 Këpucë mbrojtëse kundër produkteve kimike – Pjesa 3: Kërkesat për këpucët me shkallë të lartë rezistueshmërie ndaj produkteve kimike në kushtet laboratorike	2006	Fp
215.	S SH EN 13911:2004 Veshje mbrojtëse për zjarrfikësit – Kërkesat dhe metodat e provave për skufjet për zjarrfikësit	2004	Fp
216.	S SH EN 13921:2007 Pajisje mbrojtëse personale – Parimet ergonomike	2007	Fp
217.	S SH EN 13949:2003 Pajisje për frymëmarrje – Pajisje për frymëmarrje në zhytje me qark të hapur me vetëpërmbytje për t'u përdorur me Nitrox dhe oksigjen të ngjeshur – Kërkesat, provat, markimi	2003	Fp
218.	S SH EN ISO 13982-1:2004 Veshje mbrojtëse për përdorim kundra grimcave të ngurta – Pjesa 1: Kërkesat e performancës për veshjet mbrojtëse kundër produkteve kimike që ofrojnë një mbrojtje të të gjithë trupit kundër grimcave të ngurta që transportohen nga ajri (veshje e tipit 5) (ISO 13982-1:2004)	2004	Fp
219.	S SH EN ISO 13982-2:2004 Veshje mbrojtëse për përdorim kundër grimcave të ngurta – Pjesa 2: Metoda e provës për përcaktimin e përshkueshmërisë së brendshme në rroba të aerosoleve të grimcave të vogla (ISO 13982-2:2004)	2004	Fp
220.	S SH EN ISO 13995:2000 Veshje mbrojtëse – Vetitë mekanike – Metoda e provës për përcaktimin e rezistencës ndaj shpimit dhe ndaj shqyerjes dinamike të materialeve (ISO 13995:2000)	2000	Fp
221.	S SH EN ISO 13997:1999 Veshje mbrojtëse – Vetitë mekanike – Përcaktimi i rezistencës në prerje nga objektet e mprehta (ISO 13997:1999)	1999	Fp
	S SH EN ISO 13997:1999/AC:2000	2000	Fp
222.	S SH EN ISO 13998:2003 Veshje mbrojtëse – Përparëset, pantallonat dhe jelekët mbrojtës kundër prerjeve dhe shpimeve nga thikat e dorës (ISO 13998:2003)	2003	Fp
223.	S SH EN 14021:2003 Mbrojtëset prej guri për garat me motoçikleta jashtë rrugëve të vendosura për të mbrojtur motoçiklistët nga gurët dhe nga copat e gurëve – Kërkesat dhe metodat e provave	2003	Fp
224.	S SH EN 14052:2005 Helmata industriale me performancë të lartë	2005	Fp
225.	S SH EN 14058:2004 Veshje mbrojtëse – Veshmbathjet për mbrojtje nga mjediset e ftohta	2004	Fp
226.	S SH EN ISO 14116:2008 Veshje mbrojtëse – Mbrojtja kundër të nxehtit dhe flakës –	2008	Fp

	Materialet kufizuese për përhapjen e flakës dhe montimet e materialeve (ISO 14116:2008)		
227.	S SH EN 14120:2003 Veshje mbrojtëse – Mbrojtëset e kyçit, të pëllëmbës, të gjurit dhe të bërrylit për përdoruesit pajisjeve të sporteve me top në formë ruli	2003	Fp
	S SH EN 14120:2003/A1:2007	2007	Fp
228.	S SH EN 14126:2003 Veshje mbrojtëse – Kërkesa për performancën dhe metodat e provave për veshjet mbrojtëse kundër agjentëve infektivë	2003	Fp
229.	S SH EN 14143:2003 Pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes – Pajisje për zhytje, autonome, me qark të mbyllur	2003	Fp
230.	S SH EN 14225-1:2005 Kostume zhytjeje – Pjesa 1: Komplet veshjeje i njomë – Kërkesat dhe metodat e provës	2005	Fp
231.	S SH EN 14225-2:2005 Kostume zhytjeje – Pjesa 2: Komplet veshjeje hermetik – Kërkesat dhe metodat e provës	2005	Fp
232.	S SH EN 14225-3:2005 Kostume zhytjeje – Pjesa 3: Komplet veshjeje me sisteme ngrohjeje ose ftohje aktive – Kërkesat dhe metodat e provës	2005	Fp
233.	S SH EN 14225-4:2005 Kostume zhytjeje – Pjesa 4: Kostume të zhytjes në presion atmosferik (ADS) – Kërkesat për faktorët humanë dhe metodat e provës	2005	Fp
234.	S SH EN 14325:2004 Veshje mbrojtëse kundër kimikateve – Metodat e provave dhe klasifikimi sipas performancave të materialeve, të bashkimeve dhe të tërësive të veshjeve të mbrojtjes kimike	2004	Fp
235.	S SH EN 14328:2005 Veshje mbrojtëse – Doreza dhe mbrojtëse kralesh kundër prerjeve nga instrumentet prerës të makinerive	2005	Fp
236.	S SH EN 14360:2004 Veshje mbrojtëse kundër shiut – Metoda e provës për veshmbathjet e gatshme për t'u veshur – Impakti i veshmbathjeve me pikat me energji të lartë	2004	Fp
237.	S SH EN 14387:2004/A1:2008 Pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes – Filtrat e gazit dhe filtrat e kombinuar – Kërkesat, provat, markimi	2008	Fp
238.	S SH EN 14404:2004 Pajisje mbrojtëse personale – Mbrojtëse gjuri për punën që kryhet në pozicionin në gju	2004	Fp
239.	S SH EN 14435:2004 Pajisje mbrojtëse të frymëmarrjes – Aparate mbrojtëse të frymëmarrjes me funksion të pavarur, me qark të hapur të ajrit të	2004	Fp

	ngjeshur, me gjysmëmaskë të destinuar për t'u përdorur vetëm për presion pozitiv		
240.	S SH EN 14458:2004 Pajisje personale për mbrojtjen e syrit – Ekran mbrojtës fytyre dhe maskë për përdorim me helmetat e zjarrfikësve dhe helmetat industriale me performancë të lartë që përdoren nga zjarrfikësit, shërbimet e ambulancave të emergjencës	2004	Fp
241.	S SH EN ISO 14460:1999 Veshje mbrojtëse për pilotët e garave me automobila – Mbrojtja nga nxehtësia dhe flaka – Kërkesat cilësore dhe metodat e provave (ISO 14460:1999)	1999	Fp
	S SH EN ISO 14460:1999/A1:2002	2002	Fp
	S SH EN ISO 14460:1999/AC:1999	1999	Fp
242.	S SH EN 14529:2005 Pajisje mbrojtëse të frymëmarrjes – Aparate mbrojtëse të frymëmarrjes me funksion të pavarur, me qark të hapur të ajrit të ngjeshur, me gjysmëmaskë të destinuar të përmbajë një valvul me presion pozitiv që komandohet nga nevoja e mushkërisë, vetëm për qëllime shpëtimi	2005	Fp
243.	S SH EN 14572:2005 Helmetat me performancë të lartë për sportet e hipizmit	2005	Fp
244.	EN 14593-1:2005 Pajisje mbrojtëse të frymëmarrjes – Aparate mbrojtëse të frymëmarrjes me linjë ajri të ngjeshur me valvul sipas kërkesës – Pjesa 1: Aparat me maskë fytyre të plotë – Kërkesat, prova dhe markimi	2005	Fp
245.	S SH EN 14593-2:2005 Pajisje mbrojtëse të frymëmarrjes – Aparate mbrojtëse të frymëmarrjes me linjë ajri të ngjeshur me valvul sipas kërkesës – Pjesa 2: Aparat me gjysmëmaskë fytyre në presion pozitiv – Kërkesat, prova dhe markimi	2005	Fp
	S SH EN 14593-2:2005 /AC:2005	2005	Fp
246.	S SH EN 14594:2005 Pajisje mbrojtëse të frymëmarrjes – Aparate mbrojtëse të frymëmarrjes me linjë ajri të ngjeshur me rrjedhje të vazhduar – Kërkesat, prova dhe markimi	2005	Fp
	S SH EN 14594:2005 /AC :2005	2005	Fp
247.	S SH EN 14605:2005 Veshje mbrojtëse – Mbrojtja nga kimikatet e lëngshme – Pjesa 1: Kërkesat e performancës për veshjet mbrojtëse nga spërkatjet kimike dhe të pjesëve bashkuese që kanë të njëjtin funksion (pajisje të tipit 3) ose (pajisje të tipit 4), përfshirë artikujt që mbrojnë vetëm pjesët e trupit (tipi PB [3] dhe PB [4])	2005	Fp

248.	S SH EN 14786:2006 Veshje mbrojtëse – Përcaktimi i rezistencës në depërtim me anë të produkteve kimike të lëngëta të sprucuar, emulsioneve dhe dispersioneve – Prova me pluhurues	2006	Fp
249.	S SH EN ISO 14877:2002 Veshje mbrojtëse për operacionet abrazive me shpërthim që përdorin gërryerjen kokrrizore (ISO 14877:2002)	2002	Fp
250.	S SH EN ISO 15025:2002 Veshje mbrojtëse – Mbrojtja kundër nxehtësisë dhe flakës – Metoda e provës për përhapje të kufizuar të flakës (ISO 15025:2000)	2002	Fp
251.	S SH EN ISO 15027-1:2002 Kostume zhytjeje – Pjesa 1: Kërkesat, përfshirë sigurinë, për kostumet e përhershme (ISO 15027-1:2002)	2002	Fp
252.	S SH EN ISO 15027-2:2002 Kostume zhytjeje – Pjesa 2: Kërkesat, përfshirë sigurinë, për kostumet e heqshme (ISO 15027-2:2002)	2002	Fp
253.	S SH EN ISO 15027-3:2002 Kostume zhytjeje – Pjesa 3: Metodat e provave (ISO 15027-3:2002)	2002	Fp
254.	S SH EN 15090:2006 Këpucë për zjarrfikësit	2006	Fp
255.	S SH EN 15333-1:2008 Pajisje për frymëmarrje – Pajisje për zhytje me qark të hapur, me gaz të ngjeshur që ushqehen nëpërmjet tubit – Pajisjet sipas kërkesës	2008	Fp
256.	S SH EN 15613:2008 Mbrojtëse gjuri dhe bërryli për sportet në mjedise të mbuluara – Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës	2008	Fp
257.	S SH EN 15614:2007 Veshje mbrojtëse për zjarrfikës – Metodat laboratorike të provës dhe kërkesat e performancës për veshjet që vishen në luftën kundër zjarreve në pyje	2007	Fp
258.	S SH EN ISO 15831:2004 Veshje – Efektet fiziologjike – Matja e izolimit termik me anën e një manekini termik (ISO 15831:2004)	2004	Fp
259.	S SH EN ISO 17249:2004 Këpucët e sigurisë rezistente ndaj prerjes me sharrë me zinxhir (ISO 17249:2004)	2004	Fp
	S SH EN ISO 17249:2004/A1:2007	2007	Fp
260.	S SH EN ISO 17491-3:2008 Veshje mbrojtëse – Metodat e provës për veshjet që sigurojnë mbrojtje kundër produkteve kimike - Pjesa 3: Përcaktimi i rezistencës së depërtimit nëpërmjet një hedhje të lëngut (prova e hedhjes) (ISO 17491-3:2008)	2008	Fp
261.	S SH EN ISO 17491-4:2008	2008	Fp

	Veshje mbrojtëse – Metodat e provës për veshjet që sigurojnë mbrojtje kundër lëngjeve kimike – Pjesa 4: Përcaktimi i rezistencës së depërtimit nëpërmjet një spërklimi të lëngut (prova e spërklimit (ISO 17491-4:2008)		
262.	S SH EN ISO 20344:2004 Pajisje mbrojtëse personale – Metodat e provës për këpucët (ISO 20344:2004)	2004	Fp
	S SH EN ISO 20344:2004/A1:2007	2007	Fp
	S SH EN ISO 20344:2004/AC:2005	2005	Fp
263.	S SH EN ISO 20345:2004 Pajisje mbrojtëse personale – Këpucët e sigurisë (ISO 20345:2004)	2004	Fp
	S SH EN ISO 20345:2004/A1:2007	2007	Fp
	S SH EN ISO 20345:2004/AC:2007	2007	Fp
264.	S SH EN ISO 20346:2004 Pajisje mbrojtëse personale – Këpucët mbrojtëse (ISO 20346:2004)	2004	Fp
	S SH EN ISO 20346:2004/A1:2007	2007	Fp
	S SH EN ISO 20346:2004/AC:2007	2007	Fp
265.	S SH EN ISO 20347:2004 Pajisje mbrojtëse personale – Këpucët profesionale (ISO 20347:2004)	2004	Fp
	S SH EN ISO 20347:2004/A1:2007	2007	Fp
	S SH EN ISO 20347:2004/AC:2007	2007	Fp
266.	S SH EN 24869-1:1992 Akustika – Mbrojtëset e dëgjimit – Metoda subjektive për matjen e zbutjes së zhurmës (ISO 4869-1:1990)	1992	Fp
267.	S SH EN 50286:1999 Veshjet mbrojtëse me izolim elektrik për instalimet me tension të ulët	1999	Fp
268.	S SH EN 50321:1999 Këpucë me izolim elektrik për punime në instalimet elektrike me tension të ulët	1999	Fp
269.	S SH EN 50365:2002 Helmata me izolim elektrik për përdorim në instalimet me tension të ulët	2002	Fp
270.	S SH EN 60743:2001 Punime nën tension – Terminologjia për mjetet, aparatet dhe pajisjet (IEC 60743:2001)	2001	Fp
271.	S SH EN 60895:2003 Punime nën tension – Veshjet përçuese për përdorim në tension nominal deri në 800 kV rrymë alternative dhe \pm 600 kV rrymë e vazhduar (IEC 60895:2002 (Modifikuar))	2003	Fp

272.	S SH EN 60903:2003 Punime nën tension – Dorashka prej materiali izolues (IEC 60903:2002 (Modifikuar))	2003	Fp
273.	S SH EN 60984:1992 Mbrojtëse të krahëve prej materiali izolues për punime nën tension (IEC 60984:1990 (Modifikuar))	1992	Fp
	S SH EN 60984:1992/A11:1997	1997	Fp
	S SH EN 60984:1992/A1:2002 (IEC 60984:1990/A1:2002)	2002	Fp

UDHËZIM
Nr.8, datë 10.12.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË PROCEDURAVE TË DHËNIES TË SË DREJTËS
SUBJEKTEVE JURIDIKE, PËR MARRJEN, NË DISPOZICION, TË SIPËRFAQEVE TË
PARASHIKUARA PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE E ZHVILLIMIN E VEPRIMTARISË
PËRKATËSE NË ZONËN ENERGJETIKE DHE INDUSTRIALE TË PORTO-ROMANOS,
DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 21 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të pikës 3 të vendimit nr.703, datë 23.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e studimit “Zhvillimi i integruar (në sinergji) i zonës energjetike dhe industriale të Porto-Romanos, Durrës, infrastruktura dhe konturet e saj””, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Subjektet, që kërkojnë të ndërtojnë dhe të përdorin objekte ose instalime energjetike dhe industriale, si dhe objekte shërbimesh në funksion të tyre, në sipërfaqet e truallit të përfshira në zonën energjetike dhe industriale të Porto-Romanos, Durrës, në vazhdim e quajtur “Zona”, brenda vijave kufizuese të përcaktuara sipas masterplanit të “Zonës” të miratuar me vendimin nr.2, datë 14.7.2009 të KRRTRSH-së “Për miratimin e masterplanit për zhvillimin e integruar të zonës energjetike dhe industriale të Porto-Romanos, Durrës, infrastruktura dhe vija kufizuese e saj”, në vazhdim të quajtur “Masterplani” dhe në rast se veprimtaria që kërkohet të realizohet nuk trajtohet në mënyrë specifike nëpërmjet ndonjë akti tjetër ligjor ose nënligjor, kanë të drejtën të pajisen me autorizimin përkatës, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Ministria përgjegjëse për veprimtarinë energjetike dhe industriale, në vazhdim e quajtur “Ministria”, të informojë për zonat e përcaktuara për ndërtimin dhe përdorimin e objekteve energjetike dhe industriale sipas skemës së vendosjes së tyre në hapësirat e përcaktuara me vendimin e nr.703, datë 23.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratim e studimit “Zhvillimi i integruar (në sinergji) i zonës energjetike dhe industriale të Porto-Romanos, Durrës, infrastruktura dhe konturet e saj””, në vazhdim të quajtur “Studimi”, si dhe për sipërfaqet për ndërtimin e tyre, sipas “Masterplanit”, të miratuar me vendimin nr.2, datë 14.7.2009 të KRRTRSH-së.

Informimi të bëhet nëpërmjet publikimit të një materiali përmbledhës për “Masterplanin” dhe këtij udhëzimi në faqen e internetit të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Informimi të bëhet edhe në median e shkruar dhe elektronike, si dhe nëpërmjet seminareve promovuese që do të zhvillohen një herë në vit.

3. Ministria në bazë të dokumentacionit që disponon për “Masterplanin”, të vërë në dispozicion të shoqërive të interesuara informacionin e nevojshëm për hartimin e projekteve, kundrejt një pagese prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh.

4. Objektet energjetike dhe industriale që do të kërkohen për t'u ndërtuar në "Zonë" duhet të jenë të njëjta ose brenda natyrës dhe fushave të veprimtarive në përputhje me parashikimet në "Studim", dhe në "Masterplan".

Në "Zonë", në përputhje me kapacitetet e parashikuara në "Masterplan" për një objekt energjetik ose industrial, mund të ndërtohen dhe shfrytëzohen nga subjekte të ndryshme disa objekte të së njëjtës natyrë, kapaciteti i përbashkët i të cilave është i përafërt me kapacitetin e parashikuar në "Masterplan" për këtë lloj veprimtarie.

5. Në sipërfaqet e tokës që janë përfshirë brenda kontureve të "Zonës", sipas "Masterplanit", nuk do të lejohet dhënia e lejeve dhe miratimeve për ndërtimin e objekteve për veprimtari prodhuese ose shërbimesh, të cilat nuk u përkasin fushave të energjetikës, industrisë dhe shërbimeve, sikurse përcaktohen në qëllimin dhe objektin e "Studimit".

6. Për ndërtimin e infrastrukturës së transportit rrugor dhe të atij teknologjik të produkteve dhe mallrave, me investime publike ose private në sipërfaqet e tokës që janë në pronësi shtetërore, në kuadër të "Zonës", toka do të merret në përdorim pa shpërbllim për të gjithë periudhën, gjatë së cilës investitori do të ketë të drejtë për atë infrastrukturë transporti rrugor ose teknologjik.

Kur toka është në pronësi private, marrëdhëniet ndërmjet investitorit, që do të ndërtojë infrastrukturë transporti rrugor ose teknologjik, dhe pronarit të tokës, do të zgjidhen ndërmjet palëve në përputhje me dispozitat e kuadrit ligjor në fuqi.

7. Shoqëritë e interesuara, që kërkojnë të marrin, në dispozicion, për një periudhë të caktuar kohe një sipërfaqe në "Zonë", me qëllim përgatitjen e të gjitha praktikave dhe dokumentacionit të nevojshëm për ndërtim e përdorim të objekteve energjetike e industriale dhe zhvillimin e veprimtarive përkatëse në sipërfaqet e truallit të përcaktuara në "Masterplan", duhet të paraqesin në "Ministri" kërkesën të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) dokumentacionin që vërteton se subjekti është person juridik në formën e shoqërisë anonime;
- b) projektidenë për llojin dhe destinacionin e objektit që kërkohet të ndërtohet, teknologjinë që do të përdoret, si dhe kapacitetin prodhues;
- c) lejen e mjedisit të veprimtarisë, bazuar në Vlerësimin Strategjik Mjedisor, si dhe në studime dhe vlerësime mjedisore për "Zonën";
- ç) skemat e zonës ku kërkohet të ndërtohet objekti, si dhe sipërfaqen e saj në m²;
- d) skemë-idenë e lidhjes së objektit me infrastrukturën e transportit dhe me infrastrukturën energjetike në rajon;
- dh) dokumentet që përcaktojnë marrëdhëniet që kanë këto shoqëri për sipërfaqen e tokës, në të cilën parashikohet ndërtimi i objektit, si dhe infrastrukturën lidhëse të tij;
- e) vlerësimin e përafërt financiar për investimin që do të realizohet, si dhe dokumentin bankar për të vërtetuar mundësitë financiare për përballimin e vlerës së investimit të parashikuar;
- ë) dokumentacionin e duhur për të treguar përvojën në fushën e ndërtimit dhe të përdorimit të objekteve e të teknologjive të njëjta ose të përafërta me teknologjinë që do të realizojë, nëse subjekti e zotëron një përvojë të tillë, ose mënyrën se si mund ta sigurojë atë.

8. Trajtimi i kërkesave dhe i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e interesuara, sipas përcaktimit në pikën 7 të këtij udhëzimi, bëhet nga strukturat përgjegjëse të "Ministrit". Ministri përgjegjës për veprimtarinë energjetike dhe industriale, në vazhdim i quajtur "Ministri", urdhëron ngritjen e një grupi pune që do të bëjë vlerësimin e kërkesës dhe të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti kërkues. Si rregull, grupi i punës drejtohet nga zëvendësministri që mbulon fushën e veprimtarisë ku përfshihet dhe objekti, për të cilin është paraqitur kërkesa.

Në përbërje të grupit të punës mund të thirren për të marrë pjesë edhe ekspertë të institucioneve të varësisë të "Ministrit", si dhe nga strukturat përkatëse të ministrit përgjegjës për veprimtarinë e ndërtimit dhe të transportit, të ministrit përgjegjës për mjedisin.

Në varësi të natyrës së objektit dhe të teknologjisë që do të përdoret, struktura përgjegjëse e "Ministrit" mund të kërkojë edhe një vlerësim oponent nga institucione ose ekspertë të fushës përkatëse për projektidenë e objektit, si dhe, sipas rastit, mund të marrë mendim nga strukturat përkatëse të ministrit përgjegjës për veprimtarinë e ndërtimit dhe të transportit, të ministrit përgjegjës për mjedisin ose të institucioneve të tjera.

9. Trajtimi i kërkesave nga strukturat përgjegjëse të “Ministrisë”, si dhe realizimi i vlerësimit të tyre nga grupi i punës i ngritur me urdhër ministri, përfshirë edhe verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në mbështetje të “Masterplanit”, bëhen brenda një periudhe jo më shumë se një muaj nga data e paraqitjes së kërkesës, si më poshtë vijon:

a) Në përfundim të vlerësimit, në rastin kur ai konsiderohet i pranueshëm, nëpërmjet praktikës institucionale, i propozohet “Ministrit” t’i japë subjektit kërkuar “autorizimin” për vënien në dispozicion të sipërfaqes për ndërtimin e objektit dhe instalimin e teknologjisë përkatëse në zonën e kërkuar.

Dhënia e “autorizimit” duhet të bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data kur grupi i punës ka përfunduar vlerësimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti.

b) Në rast se, sipas vlerësimit që i bëhet aplikimit të paraqitur nga subjekti, rezulton se shtrirja hapësinore, natyra dhe destinacioni i veprimtarisë së objektit që kërkohet të ndërtohet në një sipërfaqe të caktuar të “Zonës”, nuk janë sipas kushteve të “Masterplanit”, por objekti i përket fushave të energjetikës e industrisë dhe për këtë sipërfaqe nuk ka një propozim alternativ sipas kushteve të “Masterplanit”, dhe grupi i punës e vlerëson të pranueshëm këtë aplikim, në këtë rast i propozohet “Ministrit” që t’i japë subjektit kërkuar “autorizimin” për vënien në dispozicion të sipërfaqes për ndërtimin e objektit dhe instalimin e teknologjisë përkatëse në zonën e kërkuar sipas propozimit përkatës.

Në këtë rast është e domosdoshme që në përbërje të grupit të punës, që do të bëjë vlerësimin e aplikimit të paraqitur nga subjekti i interesuar, të marrin pjesë përfaqësues nga strukturat përkatëse të ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë e ndërtimit dhe të transportit, të ministrisë përgjegjëse për mjedisin, si dhe të Ministrisë së Financave.

Dhënia e autorizimit duhet të bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data kur grupi i punës ka përfunduar vlerësimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti.

c) Në rast se, pas përfundimit të vlerësimit, rezulton se objekti që kërkohet të ndërtohet dhe teknologjia që do të instalohet në të nuk janë të fushave të energjetikës dhe të industrisë, dhe nuk janë në përputhje me destinacionin e përcaktuar në “Masterplan”, grupi i punës dhe strukturat përgjegjëse të “Ministrisë” i paraqesin “Ministrit” argumentimin e vlerësimit, duke propozuar që t’i kthehet subjektit praktika përkatëse, shoqëruar me arsyetimin për këtë qëndrim.

ç) Në rast se rezulton se subjekti nuk ka plotësuar qoftë edhe njërin nga kërkesat e pikës 7 të këtij udhëzimi, atëherë subjektit i kthehen dokumentet për plotësim.

Në rastin kur subjekti nuk është dakord me këtë vlerësim të “Ministrisë”, i kërkon Këshillit të Ministrave të shqyrtojë pretendimet e tij, si dhe mund të ndjekë rrugën e ankimit në gjykatë.

10. Për rastet kur për të njëjtën sipërfaqe paraqiten njëkohësisht (brenda periudhës që bëhet vlerësimi i kërkesave), më shumë se një aplikim, të cilat i plotësojnë kërkesat e pikës 7 të këtij udhëzimi, grupi i punës i ngritur për vlerësimin e kërkesave i paraqet “Ministrit” sugjerimin për trajtimin mbi bazën e konkurrimit të këtyre kërkesave. Procedurat e konkurrimit të jenë të ngjashme me ato të koncesioneve.

11. Në përmbajtje të “autorizimit” që do t’i jepet subjektit kërkuar duhet të përcaktohen:

a) Emri dhe personaliteti juridik i shoqërisë që paraqet kërkesën.

b) E drejta e subjektit për të investuar në zonën përkatëse, në përputhje me “Masterplanin”, duke identifikuar territorin për investim. Procedurat e dhënies së sheshit dhe lejes së ndërtimit duhet të kryhet në përputhje me ligjet nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, si dhe ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

c) Afati kohor, brenda të cilit duhet të përfundojë përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e lejeve ose autorizimeve të nevojshme të parashikuara në legjislacionin shqiptar në fuqi, për ndërtimin, vënien në funksionim dhe përdorimin e objektit që kërkohet të ndërtohet.

Ky afat, në çdo rast, nuk mund të jetë më shumë se 2 (dy) vjet.

ç) Mënyra e lidhjes së objektit dhe të infrastrukturës së tij të transportit dhe asaj teknologjike, me infrastrukturën e transportit dhe energjetike të “Zonës”, si dhe të rajonit.

d) Mënyra dhe forma e marrjes në përdorim ose pronësi të tokës në zonën ku do të ndërtohet objekti, si dhe infrastruktura që do të lidhë këtë objekt me atë të “Zonës” dhe të rajonit.

Në rast se infrastruktura lidhëse që do të ndërtohet do të jetë e përbashkët me atë të objekteve të tjera ose me infrastrukturën publike, do të specifikohen detyrimet që ka subjekti për tokën dhe ndërtimin e infrastrukturës, duke respektuar “Masterplanin”.

Në autorizim do të referohen (citohen) edhe marrëveshje ose kontrata të mëparshme që mund të kenë lidhje me objektin ose infrastrukturën që trajtohet në rastin konkret.

dh) marrëdhëniet me infrastrukturën portuale, të ndërtuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9298, datë 28.10.2004 “Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit, të formës “BOT”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës”, të ndryshuar, si dhe me instalimet bregdetare për transportimin dhe depozitimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në “Zonë” (depozitat dhe tubacionet me pajisjet përkatëse), në rast se kjo është një kërkesë e teknologjisë që do të instalojë dhe do të përdorë subjekti.

12. Në rastin kur i gjithë trualli ose një pjesë e tij, mbi të cilin do të ndërtohen objektet energjetike ose industriale, është pronë publike që zotërohet nga organet e pushtetit qendror ose organet e pushtetit vendor, subjekti e merr atë në zotërim sipas procedurave të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi, nëpërmjet kontratës përkatëse, me kushtin që në rastin kur nuk merret leja e ndërtimit në KRRTRSH, kjo kontratë është e pavlefshme.

13. Në rastin kur toka, mbi të cilën do të ndërtohen objektet energjetike ose industriale, si dhe infrastruktura e transportit dhe e teknologjisë, është pronë private, në përbërje të “Zonës” së përcaktuar me “Masterplanin”, dhe subjektet nuk arrijnë në marrëveshje me pronarët, atëherë subjekti i interesuar mund të paraqesë në “Ministri” kërkesën për shpronësimin për interes publik, në zbatim të pikës 2 të nenit 9 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar.

Ministria përgjegjëse për veprimtarinë energjetike dhe industriale ndjek procedurat e shpronësimit në përputhje me kriteret dhe afat e përcaktuara të legjislacionit në fuqi.

14. Në rast se brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 11 të këtij udhëzimi, subjekti nuk ka përfunduar praktikën dhe dokumentacionin për fillimin e punimeve për ndërtimin e objektit energjetik ose industrial në përputhje me kushtet e përcaktuara në autorizim, sipas së cilit i ishte vënë në dispozicion sipërfaqja përkatëse në “Zonë”, subjekti e humb këtë të drejtë dhe kjo sipërfaqe toke është e lirë për t’iu vënë në dispozicion ndonjë shoqërie tjetër, nëse do të ketë kërkesa.

15. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, referuar në qëllimin dhe objektin e studimit “Zhvillimi i integruar (në sinergji) i zonës energjetike dhe industriale të Porto-Romanos, Durrës, infrastruktura dhe konturet e saj”, të miratuar me vendimin nr.703, datë 23.4.2008 të Këshillit të Ministrave, si dhe të “Masterplanit për zhvillimin e integruar të zonës energjetike dhe industriale të Porto-Romanos, Durrës, infrastruktura dhe vija kufizuese e saj”, të miratuar me vendimin nr.2, datë 14.7.2009 të KRRTRSH-së, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, të përcaktojë njësitë ose strukturat që do të bëjnë trajtimin dhe vlerësimin e kërkesave e të dokumentacionit që do të paraqitet nga subjekte të ndryshme për marrjen, në dispozicion, të sipërfaqeve të parashikuara për ndërtimin e objekteve dhe zhvillimin e veprimtarisë përkatëse në “Zonë”.

16. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njoftojmë se kanë filluar abonimet për vitin 2011 për Fletoren Zyrtare.

Afati i abonimit mbaron më 31.1.2011.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 13.1.2011

Doli nga shtypi më 15.1.2011

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 32 lekë